



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1079/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Kymete Kicaj dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Kushtrim Zogaj, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Malishevë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.1079/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga Kushtrim Zogaj, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Malishevë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021, nga Kushtrim Zogaj, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Malishevë, me të cilën pretendon se në vendvotimet 3047a/01R, 3047A/02D, 3031A/01R dhe 3031A/02D ka ndodhur shtrembërim dhe pasqyrim jo i drejtë i votave në Formularët e Rezultateve për Kandidat-FRK. Më tej parashtruesi i apelit shton se këto pretendime i bazon duke u mbështetur në deklaratimet e votuesve.

Parashtruesi i apelit nuk ka bashkangjitur asnjë provë, si dëshmi lidhur me pretendimet në apel.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara shtrembërim dhe pasqyrim jo të drejtë të rezultateve edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mos përfshirje të

votave apo manipulime të votave të parashtruesit të apelit, për faktin se thëniet e tij nuk mbështeten në asnjë provë konkrete por janë të përgjithshme e jo të konkretizuara, sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mos përfshirje të saktë votave në rezultate përfundimtare, andaj pala ankuese nuk i ka argumentuar shkeljet e pretenduara në apel.

Si përfundim, Paneli vlerësoi se apeli i Kushtrim Zogaj, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës, nga subjekti politik PDK, dega në Malishevë, nuk është bazuar në asnjë dëshmi bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit apo regjistrimit të votave për kandidat, andaj kërkesa e apellesit për të rinumëruar fletëvotimet e kandidatëve për kuvend komunal në vendvotimet e lartcekura , vlerësohet si i pa bazuar.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli parashtruar nga Kushtrim Zogaj, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës, nga subjekti politik PDK, nuk është i bazuar me asnjë dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje apo parregullsi gjatë numërimit të votave.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.1079/2021 më datën 07.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.